



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 98/13
Prishtinë, më 13.03.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Sali Asllanaj, Duda Balje dhe Sevdije Lama.

Munguna: Jelena Bontic, Hykmete Bajrami dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidnetes.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 07.03.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-156 për kontrollin e duhanit, me amendamentet Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04./L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Miniera dhe Minerale, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura e Komisionit dt. 07.03.2013

Kryetarja konstatoj se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-156 për kontrollin e duhanit, me amendamentet Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetarja njoftoi se sipas deklaratës së ministrisë së sponzorizuese që është mbështetur edhe nga Departamenti i Buxhetit në MF, shofim se për zbatimin e këtij ligji kërkohen të punësohen punëtor të rinj dhe mjete shtesë buxhetore. Mirëpo nëse shikojmë përmbajtjen e projektligjit dhe amendamentet e komisionit funksional shofim se nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Nëse ministria sponzorizuese mendon se duhet shtuar numri i të punësuarve dhe mejteve tjera buxhetore, atëherë kërkesat duhet parashtrijë në procedurën e rregullt buxhetore.

Komisioni me shtatë vota Për (Safete Hadergjona, Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Sali Asllanaj, Duda Balje dhe Sevdije Lama), një Abstenim (Albana Fetoshi) dhe anjë Kundër, nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji për kontrollin e duhanit dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04./L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Miniera dhe Minerale, me amendamentet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja theksoi se ky projektligj është hartuar nga komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe nga analizat që i janë dispozitave të projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional, nuk kemi vërejtur se prodhon kosto shtesë buxhetore.

Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Miniera dhe Minerale dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Të ndryshme

5.1. Kryetarja informoi anëtarët e komisionit për rrjedhën e punës së grupit punues për shqyrtimin e projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësor. Grupi punues ka mbajtur dy takime në të cilat kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e ministrisë së financave dhe ministrisë së shëndetësisë dhe nuk është arritur të gjindet ndonjë zgjidhje. Në takimin e dytë ka qenë i pranishëm edhe ministri i shëndetësisë dhe nuk kemi mundur me ardhë deri në përfundim se si të qasemi aspektit buxhetor të projektligjit. Ministri në arsyetimet e tij ka thënë se odat nuk janë institucione të pavarura po janë institucione publike, por kjo ide e ministrit nuk është shtjelluar mirë në projektligj, pasi që neni 45 thotë se këto oda duhet raportojnë sipas rregullave të kontabilitetit dhe afarizmit financiar që bëhen në pajtim me ligjin për kontabilitet dhe raportim financiar, e që në bazë të këtij ligji janë të obliguar raportojnë shoqëritë tregtare. Ndërkaq me amendamentet e komisionit funksional është paraparë që odat të financohen tri vjet nga ministria e shëndetësisë, ndërkaq pas kësaj kohe nga të hyrat vetanake. Ministri në këtë takim ka kërkuar afat shtesë që të analizojë më shumë këtë qështje dhe të del me propozime konkrete. Problemi kryesor nuk është rregulluar si duhet me këtë projektligj, qështja e themelimit të statusit të këtyre odave, e që si rrjedhojë po paraqet problem në definimin e qështjeve tjera buxhetore dhe financiare.

Naser Osmani qëshja e pavarësisë financiare është problem pasi që ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë përcakton se çdo e hyrë publike të duhet të kalojë përmes thesarit dhe shfrytëzimi i tyre mund të bëhet përmes një memorandumit të mirëkuptimit. Këto oda mund të kenë pavarësinë profesionale dhe ti ndahen buxhet për veprimtarin e këtyre institucioneve në mënyrë të rregullt buxhetore, mirëpo me pavarësi një institucion prej buxhetit dhe i cili i ka kompetencat me i detyru njerëzit për tu bërë anëtarët në këto oda dhe me marrë licencën në mënyrë obligative paraqet rrezik në mënyrën menaxhimin e mjeteve të grumbulluara. Kuptimi i pavarësisë ka të bëjë me mënyrën e punës që është themeluar një institucion apo agjension, por nuk do të thotë të jetë i pavarur në shpenzimet e mjeteve.

Sali Asllanaj ky projektligj për odat shëndetësore është në kuadër të ligjeve të pakos për reformat në sistemit shëndetësore. Ky ligj mund të kalohet, të formohet si e ka prezantuar ministri por ndoshta ka nevojë edhe të ndërhyhet, por këto qëshje qendrojnë prapa nevojës për ndryshimin e ligjit mbi menaxhimin e financave publike. Por siq po shifet është duke unguar vullneti politik sepse është dashur të studiohen më mirë këto qështje dhe meqë kemi të bëjmë me një reformë në shëndetësi, të gjinden format për miratimin e ligjeve që lidhen me këto reforma që janë në interes të përgjithshëm.

Kryetarja theksoi se problemi në miratimin e këtij ligji nuk është kostoja e lartë buxhetore, por qështjet financiare dhe buxhetore dhe lidhshmëria me ligjet tjera në fuqi, sidomos me LMFPP.

Latif Gashi unë konsideroj se themelimi i këtyre odave prej buxheti do të krijoj probleme buxhetore. Ato parashihen të financohen në të ardhmen prej të hyrave ventanake, por nuk është e rregulluar qështja e raportimit të tyre. Mendojë që se është e nevojshme të bëhet një analizë me thellë qoftë nga grupi punues, apo edhe të mbahet një takim i përbashkët me komisionin funksional, ministrinë e shëndetësisë edhe të financave dhe me gjet një zgjidhje.

Kryetarja pikërisht për këtë qështje i kemi lenë kohë ministrit për me u marr edhe ka thënë se do të analizoj të gjitha këto qështje na jep ndonjë rekomandim.

5.2. Kryetarja njoftoi se grupi punues për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë ka përfunduar punën sipas planit të veprimit, ka realizuar të gjitha vizitat e parapara në teren dhe ka hartuar draft-raportin me rekomandime dhe do të jetë i gatshëm për miratim në mbledhjen e radhës së komisionit.

5.3. Kryetarja theksoi se komisioni në planin e punës në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti ka paraparë mbikëqyerjen e zbatimit të ligjit për prokurimin publik dhe për këtë kemi caktuar grupin punues. Mendojë që anëtarët e GP punues për monitorimin e këtij ligji do të ishte mirë të qëndrojnë pas mbledhjes së komisionit dhe të bëjmë një strategji veprimi si ti qasen monitorimit të këtij projektligji.

Mbledhja përfundoi: 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona